



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr.1021/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit "Autopjesë Partner" Sh.P.K., me seli në Korishë – Prizren, me NUI: 810087157, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit D.N. avokat nga Prizreni, kundër debitorit "A.S." B.I, me NUI: 811287483, me seli në Rr. Muharrem Gashi p.n – Pejë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1778/22 të datës 09.06.2023, me datë **14.02.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të kreditorit "Autopjesë Partner" Sh.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1778/22 të datës 09.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1778/22 të datës 09.06.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit "A.S." B.I, ashtu që është anuluar Urdhri Përmbartimor P.nr.619/2021 të datës 02.11.2021, të Përmbartuesit Privat Mehdi S. Reshani dhe është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet

aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1778/22 të datës 09.06.2023 apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "Autopjesë Partner" Sh.P.K., ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës me numër: F20212031003434 e datës 31.05.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin "A.S." B.I, që në emër të borxhit sipas faturës të lartcekur, t'ia paguaj shumën prej 124.40 €, me kamatë ligjore, nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbartim si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Përmbartuesi Privat Mehdi S.Reshani me seli në Prizren duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.619/2021 të datës 02.11.2021, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim nëpërmjet të cilit e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për përmbartim për shkak se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar përmbartimi nuk paraqet dokument përmbartues meqenëse fatura është e njëanshme dhe e firmosur vetëm nga kreditori. Tutje thekson se nuk ka blerë ndonjë pjesë nga kreditori për këtë arsye edhe nuk e ka pranuar faturën. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor P.nr.619/2021 i datës 02.11.2021, i përmbartuesit privat Mehdi S. Rashani.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes të autorizuarit të tij, ndër të tjera ka deklaruar se prapësimin e konsideron si tërësisht të pa bazuar, pretendimi i debitorit

se fatura duhet të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga ana e debitorit është i pa qëndrueshëm kjo për faktin sepse faturat i janë dërguar debitorit dhe debitorit këto fatura i ka pranuar, të njëjtat nuk i ka kundërshtuar por nuk i ka paguar. Tutje deklaron se debitori me dorëshkrimin e tij ka kërkuar dhe i është pranuar kërkesa lidhur me shtyrjen e afatit të cilën i njëjti ka firmosur që do ta paguaj deri me datën 06.09.2021 por nuk e ka bërë. Andaj i ka propozuar Gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit, dhe të vërteton urdhrin përmbartimor P.nr.619/2021 të datës 02.11.2021, i përmbartuesit privat Mehdi S. Reshani, si dhe i ka kërkuar rimbursimin e të gjitha shpenzimeve të procedurës.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1778/22 të datës 09.06.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit "A.S." B.I, ashtu që është anuluar Urdhri Përmbartimor P.nr.619/2021 të datës 02.11.2021, të Përmbartuesit Privat Mehdi S. Reshani dhe është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës në rastin konkret fatura me numër: F20212031003434 e datës 31.05.2021, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban as nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë së debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, si e tillë e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes se detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 në par.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se F20212031003434 e datës 31.05.2021 si dokument në saje të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se është pranuar nga debitori, e njëjta nuk është e vërtetë dhe as nënshkruar nga debitori në mënyrë që të konsiderohet si dokument i besueshëm. Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit por të njëjta mbasin të pabazuara pasi nuk ka arrit të argumentoj me prova juridikisht të vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SH.nr.1021/23, me datë 14.02.2024

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti